



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	17.11.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-246440/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	Qendra për këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtim -SIT
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrollloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokoll 07-353/04-246440/21 nga Qendra për këshillim, shërbime sociale dhe hulumtim-SIT, përfaqësuar nga Liridona Berisha Shabani me të cilët kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi “Zahir Pajaziti me datë 06,07 dhe 08 Dhjetor 2021”.

Aktiviteti do të quhet “Tuneli i Fundit” dhe është përkujtim për disa gra viktime të femicidit në periudhën e pasluftës.

Njerëzit të cilët kalojnë nëpër tunel do të kenë mundësinë për të parë dhe lexuar dhe lexuar historitë e viktimave të femicidit si dhe statistikave të tjera të dhunës që gratë përjetojnë në Kosovë vit pas viti.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin Qendra për këshillim, shërbime sociale dhe hulumtim-SIT, përfaqësuar nga Liridona Berisha Shabani me të cilët kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi “Zahir Pajaziti me datë 06,07 dhe 08 Dhjetor 2021” sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e më parëshme;

**Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.**

Faqe 1 nga 1

30.11.2021